



**Data 27 Tetor 2006**

## Komentet nga aplikuesit për Licencat për FURNIZIM /TREGTI Për seancën Publike të datës 30 tetor 2006

Në seancën publike paraprake kemi lëshuar 4 licenca për furnizim/ tregti (1 për KEK-ut dhe 3 licenca për tregtarët të huaj).

Ndër kohë kemi analizuar 3 aplikacione për licenca të Furnizimit/Tregtisë që nuk janë vlerësuar në seancën paraprake, për kompanitë: ČEZ, OstElektra dhe Holding Slovenske Elektrane (HSE).

Me datën 16 tetor këtyre kompanive i kemi dërguar draft licencat në fomë të njëjtë si për tregtarët tjerë që janë licencuar. Pa marrë parasysh se forma e licencës për furnizim / tregti është miratuar në seancën paraprake ne kemi kërkuar komentet e tyre pasi çdo kompani ka specifika të veçantë.

Deri sot kemi marrë disa komente nga kompania Cez. Nga Ost Elektra dhe nga HSE nuk kemi marrë asnjë koment.

Komentet nga Čez-i janë konstruktive dhe rezultat i analizës së detajuar. Përgjigja në këto komente gjendet në dispozitat të tjera të draft Licencës, në Ligjet në fuqi ose në Rregullat e miratuar nga ZRRE-ja.

### **CEZ -Komenti në Nenin 7 të draft Licencës:**

Ju lutemi specifikoni formën, strukturën dhe frekuencën e raportimit (raporteve) që permenden në këtë Nen edhe pse ne mendojnë se ju me kohë do t` na dergoni më shumë informata që do të mundësojnë raportimin në menyre të duhur dhe në kohë të duhur dhe se menyra e raportimit dhe nevoja do të jenë sipas praktikës më të mirë të Rregullatoreve të tjerë në Evropë.

**Përgjigja nga ZRRE-** Neni 13.6.i licencës suaj definojnë që kërkesat e raportimit sa i përket aktivitetive që licencohen definojnë në Dorracakun e Raportimit që tani është në fazën përfundimtare të komentimit nga konsulentët tonë NERA Economic Consulting. Finalizimi pritet gjatë javës tjetër.Pas mirratimit do të publikohet në faqën tonë elektronike. Ne kemi paraparë se me ndihmën e konsulentëve tonë së shpejti do të organizojmë treningje me të gjithë të licencuarit rreth implementimit të Dorracakut. Besojmë se parimet, elementet dhe menyra e raportimit janë bazuar në përvojën më të mirë të Rregullatorëve tjerë në Evropë.

### **CEZ – Komenti në Nenin 12:**

Neni 12:“I licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon”.

Ndryshimi në kontroll është kategori e gjerë. Mendojmë që duhet të limitohet në rastet kur konditat materiale gjatë kryerjës së aktivitetin të licencuar cenojnë kryerjën e atij aktiviteti.

**Pergjigjja nga ZRRE** – Para se të vjen te ndryshimi në kontroll i licencuari duhet të raportoj këtë tek ZRRE. Ky Nen ndërlidhet edhe me Nenin 13 të licencës ku i licencuari duhet të raportoj detajet e çdo ndryshimi në informata që janë dërguar me aplikacionin për atë licencë.

Arsyeja për këtë dispozitë nuk është cenimi i aktivitetet të licencuar por lidhet me Nenin 21.1. dhe Nenit 22 c) të Ligjit të Energjisë ku ndalohen të gjitha marrëveshje dhe vendime ndërmjet ndërmarrjeve të ndërlidhura, të asociuara ose të shkruara si dhe të gjitha praktikatat nëse kanë për qëllim parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konkurrencës në tregun e energjisë përmes rregullimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kushteve tregtare, kufizimit ose kontrollimit të prodhimit, tregtimit dhe zhvillimit teknik ose investimeve në energji.

Neni 24 i Ligjit të Energjisë jep si detyrë ZRRE-së që të impelmentoj dispozita të përmendur më lartë. Për atë shkak ndryshimi në kontroll duhet të raportohet ZRRE-së paraprakisht. Të gjitha ndryshime të tjera duhet të raportohen pasi të ndodhin.

#### **CEZ – Komenti në Nenin 14.2.(b)**

Në këtë koment CEZ-i propozon që në rast se i licencuari nuk ka korrigjuar ndonjë shkelje ose gabim të kërkuar ZRRE **të definohet afati që nuk duhet të jetë më i shkurt se 35 ditët** për këtë korrigjim të veprimit.

**Pergjigjja nga ZRRE** – Neni 14.2 (b) nuk permban afat të caktuar për veprim pasi Neni 16.1 jep referencën në Rregullin për Masat Administrative dhe Gjobat ku afatet janë definuar. Pasi ky draft Rregull është publikuar në web faqën e ZRRE për komentim publik ne do ta shqyrtojmë këtë koment së bashku me Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve para seancës publike për mirratim.

#### **CEZ – Komenti në Nenin 16.5.**

“Nëse gjoba e përmendur në paragrafin 3 i shyrtohet anëtarit të Bordit të Drejtorava ose ndonjë përgjegjësi të të Licencuarit, nuk duhet të kaloj vlerën prej 300% nga të arhurat **net** mujore që merr personi nga i Licencuari”. Shtojca “net” është vetëm për shkak të klarifikimit.

**Pergjigjja nga ZRRE** - Neni 16.1 jep referencën në Rregullin për Masat Administrative dhe Gjobat ku vlera e gjobës është definuar. Edhe ky koment do të merret parasysh para seancës publike për miraton. Draft Rregulli për Masat Administrative dhe Gjobat është publikuar në ueb faqen e ZRRE -[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)).